

To:Marsilda Lushaj <marsilda-lushaj@hotmail.com>;

Kthim pergjigje Nr. 156

Pershendetje !

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 156 në regjistrin e "Kërkesave dhe Përgjigjeve", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtë vijon:

Referuar dispozitave ligjore të Udhëzimit Nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e Kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” në nenin 3.2 “Llogaritja e kontributeve nga tatimpaguesit, persona juridikë dhe fizikë, për punëmarrësit që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj” në piken 3.2.1 citohet *“Mënyra e llogaritjes dhe masa e kontributeve të sigurimeve për punëmarrësit që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, përcaktohet nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtij vendimi, për të punësuarit, që janë me kontratë pune me ose pa afat, por me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, kontributi i detyrueshëm për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, llogaritet për degët e sigurimit, barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor, në përqindjet përkatëse, mbi pagën bruto mujore sipas listëpagesës, por jo më pak se niveli i pagës minimale në shkallë vendi.*

Në zbatim të Vendim Nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendës ose i huaj, është 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë.

Për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” zgjidhet Kategoria 2. “I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj”.

Faleminderit për mirëkuptimin

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit të Asistencës dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Tel Office : 04 2276 840
Web: www.tatime.gov.al